



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji nr. 06/L-080

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KOSOVËS DHE
BASHKIMIT EVROPIAN MBI PJESËMARRJEN E KOSOVËS NË
PROGRAMIN E UNIONIT “KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) (2014-2020)”**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KOSOVËS
DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI PJESËMARRJEN E KOSOVËS NË
PROGRAMIN E UNIONIT “KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) (2014-2020)”**

Neni 1
Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020)”.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020)”, e lidhur me datën 19 dhjetor 2017.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Bashkëngjitur me këtë Ligj është Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020)”.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L-080
23 korrik 2018

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI